Republika e Kosovës

Republika Kosova — Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES 1 PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 311-318/20

Datum 11.08.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.311/20

318/20 PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë 105 dhenenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/1,-237, Ligiin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z Nuhi Pagarizi - Referues, z. Goran Milenkovié-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatoreve ekonomik: OE "LIMITPROJECT "SH.P.K. & "Mirusha Company" SH.P.K. "AK-INVEST"- Dega në Kosovë & "Aksi Project SH.P.K-Prishtinë si dhe ankesës së OE "Olti Trasing" SH.P.K.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatoreve ekonomik: "B-BARDHI SH.P.K.; Linda; EURO-1NFRASTRUKTURA"-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale në Ferizaj-projekt trevjeqar", me nr. të prok: 656-19-9164-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Ferizaj, më datën: 05.08.2020, mori këtë:

VENDIM

I.APROVOHEN si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: "LIMITPROJECT "SH.P.K. & "Mirusha Company" SH.P.K. "AK-INVEST"- Dega në Kosovë & "Aksi Project SH.P.K-Prishtinë dhe OE "Olti Trasing" SH.P.K.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale në Ferizaj-Projekt trevjeqar", me nr. të prok: 656-19-9164-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Ferizaj.

II.VERTETOHET,njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale në Ferizaj-projekt trevjeqar", me nr. të prok: 656-19-9164-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Ferizaj.

I

III. Autoriteti Kontraktues ne afat prej 10 ditésh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues per te gjitha veprimet e ndérmarra lidhur me kété aktivitet te prokurimit.

IV. Mos respektimi i kötij vendimi, detyron Panelin shqyrtues qé konform dispozitave ligjore te nenit 13 1 te Ligjit per Prokurim Publik té Kosovés nr. 04/L-042, i plotésuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligiin 05/ L-068, dhe Ligiin 05/ L-092, te ndérmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qené se ankesat e operatoréve ekonomik ankues "LIMITPROJECT "SH.P.K. & "Mirusha Company" SH.P.K. "AK-INVEST"- Dega ne Kosové & "Aksi Project SH.P.K-Prishtiné si dhe ankesés se OE "Olti Trasing" SH.P.K.-Prishtiné, aprovohen si te bazuara, i béhet kthimi i se ankesés ne shumen e deponuar me rastin e parashtrimit tö ankeses.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues qe konform nenit 31 pika 6 te rregullores se punes se OSHP-se, ne afat prej gjashtédhjeté (60) ditésh tö béjé kérkesé per kthim té sigurimit té ankesés, né te kundértén ju béhet konfiskimi i depozités dhe kéto mjete kalojné né Buxhetin e Republikés sö Kosovés.

A R SY E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "LIMITPROJECT "SH.P.K. & "Mirusha Company" SH.P.K. "AK-INVEST"- Dega né Kosové & "Aksi Project SH.P.K-Prishtiné, si palé e pa kénaqur ka deponuar ankese ne OSHP, me dt: 18.05.2020 me nr. 311/20, kundér njoftimit per dhénie te kontratés lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndértimi i Qendres Multifunksionale né Ferimj-project trevjeqar", me nr.
té prok: 656-19-9164-5- I-I, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Ferizaj, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundérShtim me nenet: I, 6, 7, 54, 56, 59, 60, 69 dhe 72 te Ligiit per Prokurimin Publik te Republikés se Kosovés si dhe nenin 39 te RRUOPP-sé

Operatori ekonomik ankues OE "Olti Trasing" SH.P.K.-Prishtiné, si pale e pa kénaqur ka deponuar ankesé né OSHP, me dt: 21.05.2020 me nr. 3 18/20, kunder njoftimit per dhénie te kontratés lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndértimi i Qendrés Multifunksionale né Ferizaj-projekt trevjegar", me nr. te prok:

656-19-9164-5-1 -I , te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK./ Komuna Ferizaj, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundérshtim me nenet: I, 6, 7, 59 dhe 72 té Ligiit pér Prokurimin Publik te Republikés se Kosovés si dhe nenet 40 dhe 41 te RRUOPP-sé

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.05.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të giitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimitnë raportin e dt: 29.05.2020, sqaron si ne vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TÈ OE ANKUES: Limit Project Sh.p.k. - Prishtine

Përgjigie në Pretendimi Nr. I. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se duke respektuar edhe vendimin TUAJ KU KENI APROVUAR, sqarimin e propozuar nga ana jone për konvertim nga Banka KOMBËTARE E MAQEDONISË SE VERIUT dhe autoriteti kontraktues i kemi prezantuar edhe vërtetimin e konvertimit te HALBANK AD SKOPJE e datës 05.05.2020 duke konvertuar vlerën e denareve ne EURO me vlerën e saktë te kontratës dhe referencës e pranimit teknik nga CAGATY për AK INVEST DOOEL.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, AK përmes e-mail-i dërgon Ietrën standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit me datës 04.05.2020 si ne vijim, po citoj: "Për referencat te cilat i keni ofruar ne valutën denar, kërkojmë nga anajuaj qe për këto vlera te referencave te na dëshmoni me një konvertim ne valutën euro nga ajo banke ne te cilën i keni realizuar transaksionet për ato projekte", ndërsa OE ankues brenda afatit përmes e-mail-i bashkangiet këto dokumente si ne viim: a) Lista interno e kursit nr. 20315380, date 05.05.2020 lëshuar nga HALKBANK SHA Shkup (Vulosur dhe nënshkruar nga personi përgiegjës i bankës) dhe vlera e konvertuar: 194.367.763 MKD 3.150.502,58 EURO e përkthyer nga përkthyesi Gjygjësor z. Agron Qerreti — Prishtine, andaj bazuar ne kërkesën për sqarim nga AK, dëshminë e prezantuar nga OE ankues dhe arsyetimin nga AK ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK — komisioni i vlerësimit ka mundur te veproj ne pajtim me nenin 52 par. 7 te LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit". Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgiigje në Pretendimi Nr. 1, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se çmimi — Grupi i OE B.Bardhi Shpk,; Linda,; EURO — INFRASTRUKTURA, ne formularin e ofertës kane paraqitur çmimin total me TVSH: 3,299,321.76 €, pas krahasimit te paramases se ofertuar dhe kontrollimit, del se grupi i OE ka bere fshehje te çmimit real, ku del vlera reale e tenderit sipas çmimeve njësi te përmasës se ofertuar ne Iartësinë prej 3,607,660.30 C, ku diferenca e çmimit real dhe

atij te paraqitur ne formularin e ofertës është 308,338.54 €, Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e

fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, si dhe duke u bazuar ne raportin e vlerësimit te datës 06.05.2020, pasi aty komisioni i vlerësimit te DEKLARAT, nuk ka dhenë asnjë arsye për eliminimin e OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, as tek infòrmatat lidhur me gabimet ne Ilogaritjet; dhe as tek informatat shtese tek sqarimet dhe rrjedhimisht komisioni i vlerësimit nuk ka respektuar vendimin për formimin e komisionit me nr. 01-33/2020 te datës 28.04.2020 si dhe nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik" si dhe neni 59 par. 3 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla". Konkretisht komisioni i vlerësimit, nuk ka vlerësuar dhe krahasuar përshkrimin e çmimeve tek paramasa dhe parallogarit te operatoreve ekonomik pjesëmarrëse ne këtë aktivitet te prokurimit, gjithashtu është përgiegjësi e komisionit te vlerësimit te analizoj, krahasoj dhe ekzaminoj, te zbulohen gabimet ne Ilogaritje dhe te gieje përqindjen e gabimit ne Ilogaritje te çmimeve te ofertave finacare nga operatoret ekonomik dhe te njoftohen përmes Ietrës standarde e njoftimit për Ilogaritje te gabuar. Duke u bazuar ne këto fakte te Iartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgiigje në Pretendimi nr.2, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se grup i OE B.Bardhi Shpk,; Linda,; EURO — INFRASTRUKTURA — ka prezantuar kamionët me korp (sipas librezës) te tipit Mercedes 308 D me tabela 662—KS--()84, Cila nuk e plotëson kriterin e kërkuar sipas FDT pika 9.1 & 9.2 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 7.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, OE ankues nuk ka dhëne ndonjë sqarim se pse kjo kamionët me korp (sipas librese) te tipit Mercese 308 D me tabela 662 — KS — 084, nuk plotëson kërkesën? Mirëpo bazuar ne nenin 9.1 & 9.2 pika

7 te FDT-se, po citoj: Kërkesa 7 - Lista e mjeteve te punës dhe atë se paku - 5 ekskavator, - 6 kamion kiper, - I kamion për transport - 5 kamioneta për transport - I cilinder (vibrues), - I Skip me rrota me lopate para dhe krah mbrapa - I Pirnunier për ngarkim-shkarkim I- Damper I - Korpë hidraulike se paku 10 metra lartësi ngritëse - I grejder, -I Autobetonjere e vogël I- Autocis terrnë për ujë - I Vinę statik përndërtimtari, - Skele ndërtimi së paku 2500m2" Dëshmia 7: Lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për këto automjete duhet te ofroj listën e mjeteve te punës te nënshkruar dhe vulosur ne origjinal te dëshmuar me libreza te regjistrimit valide, fature për blerjen (me dëshmi pagese), dud doganor në emër të kompanisë me të cilën konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë. Grupi i 0E ne listën e mjeteve ka ofruar 6 kamionët për transport, andaj konsideroj se grupi i 0E ka plotësuar këtë kërkesë te FDT-se. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgiigie në Pretendimi Nr. 3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se referencat e prezantuara për punë te ngjashme, nuk janë për punët e ngiashme, dhe si rrjedhoje duhet te eliminohen, për shkak se referenca për ndërtimin e listuar me nr. I më vlere 1,000,000.00€ është jo valide sikurse ajo e listuar me nr. 4 me vlere 3,000,000.00€, për shkak, se këto kontrata duhet te dëshmohen me leje ndërtimore dhe një pranim teknik nga një ekip profesional se punëtjanë sipas projektit apo lejes nëse janë kryer, nëse nuk ka leje ndërtimore, atëherë është objekt ilegal dhe shteti nuk duhet te favorizoje aktivitetet ilegale.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, duke u bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknik edhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2 te FDT-se, po citoj: kërkesa I Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje një vlere për punët e kryera jo me pak se 4,500,000.00 €. Deshmia I: Lista e kontratave (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te realizuara giate tri viteve te fundit nga data e njoftimit për kontrate te këtij tenderi ne origiinal, te nënshkruar dhe vulosur nga OE, te dëshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te punëve te kryera ne Iëmin e punëve te ngjashme (objekte ndërtimore dhe instalime ne objekte ndërtimore), te cilat tregojnë vlerën, datën. Grupi i 0E ka dorëzuar listën e kontratave te nënshkruar dhe vulosur te dëshmuara me kontrata dhe referenca per kryerjen e punëve te ngjashme, andaj konsideroj se grupi i 0E ka arrit te plotësoj këtë kërkesë te FDT-së. Mirëpo, AK — komisioni i vlerësimit për ędo dyshim te informacionit te dorëzuar mund te veproj sipas nenit nenit 52 par. 7 te LPP-se, po citoj: "Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të Tenderit". Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qéndrueshöm.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se tek lista e punétoréve, punétoret e kompanisé LINDA Sh.p.k. Bexhet Koxha, Gazmend Terzija dhe Isak Koxha, kane nénshkruar njé kontrate me nje person i cili eshté ne listen e punétoröve, por nuk Eshté pronar dhe as nuk ka ndonje autorizim nga noteri apo autorizim te thjeshte per nenshkrimin e kontratave. Personi i nénshkruar si pronar i kompanisé LINDA eshte Afet Terzija, gjé qe, rrjedhimisht, eliminohet 3 punétor dhe lista e punétoréve te deklaruar bie nga 71 ne 68 punetor, gjé qe nuk e plotéson kushtin sipas dosjes se tenderit.
Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizén e fakteve/déshmive te dokumentuara ne platformén elektronike e-prokurim, rrjedhén dhe analizén procedurés se prokurimit, lidhur me kété aktivitet te prokurimit, antari i grupit "Linda" Sh.p.k. ka prezantuar nje liste me 18 punetoreve te thjeshte, ne te cilén jane edhe köta punetore: Afet Terezija, Behxhet Koxha, Gazmend Terzija dhe Isak Koxha. Mirepo késaj liste i janö bashkangjitur edhe kontratat Pér kéta punétore, z Afet Terzija ka te nenshkruar kontrate ne pozitön: Kryepunétore (e nenshkruar nga dy palét dhe te vulosur), kurse kontrata Pér punétoret ne Gale jané te nénshkruar nga z. Afet Terzija — ku ne nenin I te kontratés po citoj: "Te ciIFn e pörfa#son: Afet Terzija" (si punedhenes — Pronar te nénshkruar nga palét dhe te vulosur me vule te fimres "Linda" Sh.p.k.). Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me kété pretendim mendon se AK — komisioni i vlerésimit, ka mundur té kérkoj sqarime shtesé bazuar ne nenin 59.2 dhe 72 tä LPP-sö, si dhe bazuar ne nenin 39 te RRUOPP-sö. Duke u bazuar ne kéto fakte dhe duke pas parasysh kérkesen e AK te lartpérmendur dhe analizés se mésipérme vlerésojé se pretendimi i palés ne ankese né kété piké Eshtæ pjesörisht i qöndrueshöm.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 5, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se tek lista e te punésuarve me certifikate te sigurisé, eliminohen dy punétor te cilét e kane nénshkruar kontratén me Afet Terzija, pra punétorét Gazmend Terzija dhe Isak Koxha, eliminohen nga kjo liste Pér shkak se jané me kontraté te pavlefshme dhe rrjedhimisht, nuneri i té punesuarve me certifikate te sigurise te jete: 8 nga 10 te prezantuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me kété pretendim éshté sqaruar tek pirgjigja nr. 4 mendon se AK — komisioni i vlerésimit, ka mundur té körkoj sqarime shtesé bazuar ne nenin 59.2 dhe 72 tö LPP-sö, si dhe bazuar ne nenin 39 te RRUOPP-sE. Duke u bazuar ne kéto fakte dhe duke pas parasysh kérkesén e AK te lartpermendur dhe analizes se mésipérme vlerésojé se pretendimi i paläs né ankese nö kéte pike Eshtö pjesérisht i qéndrueshöm.
Përgjigje në Pretendimi Nr. 1, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Kalkulimi i qmimit: Grupi i OE ne fonnularin e ofertés kane paraqitur qmimin total me TVSH: 3,188,000.00 €, pas krahasimit te paramases se ofertes se ofruar dhe kontrollimit, del se grupi i OE ka bere fshehje te qmimit real, ku del vlera reale e tenderit sipas qmimeve njési te paramases se ofertuar ne lartesiné prej 3,823,744.17 €, ku diferenca e qmimit real dhe atij te paraqitur ne formularin e ofertés éshté 635,744.17 €.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizén e fakteve/déshmive te dokumentuara ne platformén elektronike e-prokurim, rrjedhén dhe analizén procedurés se prokurimit, lidhur me kété aktivitet te prokurimit, si dhe duke u bazuar ne raportin e vleresimit te datés 06.05.2020, pasi aty komisioni i vlerésimit te DEKLARAT, nuk ka dhen asnjé arsye Pér eliminimin e OE pjesémarrés ne kété aktivitet te prokurimit, as tek informatat lidhur me gabimet ne Ilogaritjet; dhe as tek informatat shtese tek sqarimet dhe rrjedhimisht komisioni i vlerésimit nuk ka respektuar vendimin per formimin e komisionit me nr. 01-33/2020 te datés 28.04.2020 si dhe nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 tö LPP-sö, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do tö ekzekutojé asnjé aspekt té aktivitetit te prokurimit né njé mönyré qé redukton apo eliminon konkurrencén ne mes té operatoréve ekonomik ose qé diskriminon né dem ose nö te miré te njé ose me shume operatoreve ekonomik" si dhe neni 59 par. 3 tä LPP-sä, po citoj: "Autoriteti kontraktues do té pérmirésojé gabimet ne njé tenderé te cilat jané téresisht aritmetike, nése gabimet e tilla zbulohen giaté ekzaminimit te tenderéve sidoqofté ky pérmirésim nuk mund té jete mé shumé se dy pérqind (2%) i vlerés totale té ofertés. Ne nje rast té tillé, qmimi Pér njesi i ofertuar nga operatori ekonomik ne tenderin e tij financiar gjithmone do te konsiderohet si qmim mbizotérues mbi Gdo qmim tjeter kontradiktor. Kur nuk körkohen qmimet per njési, elementet e qmimit té vetém té qmimit total té ofruara nga operatori ekonomik né tenderin e tij financiar gjithmoné do té konsiderohen si qmim mbizotérues mbi gmimin total. Autoriteti kontraktues menjéheré do ti dérgojé té giithé tenderuesve pérkatés njö njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla". Konkretisht komisioni i vlerésimit, nuk ka vlerésuar dhe krahasuar pérshkrimin e qmimeve tek paramasa dhe parallogari te operatoreve ekonomik pjesémarrése ne kété aktivitet te prokurimit, giithashtu éshté pérgjegiési e komisionit te vlerésimit te analizoj, krahasoj dhe ekzaminoj, te zbulohen gabimet ne Ilogaritje dhe te gjeje perqindjen e gabimit ne Ilogaritje te qmimeve te ofertave finacare nga operatoret ekonomik dhe te njoftohen pérmes letrös standarde e njoftimit per Ilogaritje te gabuar. Duke u bazuar ne kéto fakte te lartpérmendur dhe analizés se mesipérme vlerésojé se pretendimi i pales nö ankese nö kéte piké öshtö i qändrueshim.

Pirgjigie nö Pretendimi nr.2: Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se prezantimi i listés se punéve nuk eshté bindés, me shume ka pune infrastrukturore sesa pune ndértimore te objekteve te ngiashme (ndértim i larte).

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizén e fakteve/déshmive te dokumentuara ne platformén elektronike e-prokurim, rrjedhén dhe analizén procedurés se prokurimit, lidhur me köte aktivitet te prokurimit, grupi i OE ka sjelle listen e kontratave te realizuar te nénshkruar dhe te vulosur ne vlere 5,041,614,91 €, dhe bazuar Kërkesat mbi mundësitë teknik edhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2 te FDT-se, po citoj: Kërkesa I Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje një vlere për punët e kryerajo me pak se 4,500,000.00 €. Dëshmia I Lista e kontratave (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te realizuara giate tri viteve te ftndit nga data e njoftimit për kontrate te këtij tenderi ne origiinal, te nënshkruar dhe vulosur nga OE, te dëshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te punëve te kryera ne lëmin e punëve te ngiashme (objekte ndërtimore dhe instalime ne Objekte ndërtimore), te cilat tregojnë vlerën, datën. Andaj bazuar nga

kjo konsideroj se grupi i operatoreve ekonomik plotëson këtë kërkesë te FDT-se. Duke u bazuar ne këto fakte te Iartpërmendur dhe analizës se mësipërrne vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgiigie në Pretendimi nrS, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se diploma e menaxherit te kontratës z. Azem Gashit, nuk është skanuar origiinali i kopjes se noterizuar, por kopja e kopjes se noterizuar, kështu qe konsiderohet e pavlefshme njëjte edhe z Fatjon Bajselmani, gjeodeti, Fadil inxhiner hidros, njëjte edhe i elektrikes. Ne dosjen e tenderit është kërkuar kopja nga origiinali.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, grupi i operatori ekonomik ka dorëzuar diplomat e stafit profesional (kopje te noterizuara), andaj dorëzimi i dokumenteve përmes platformes elektronike, dokumentet nuk janë origjinale por janë te skanuara, kjo është sqaruar edhe ne vendimin PSH. Nr. 191, 210/2020 te datës 23.04.2020.

Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me këtë pretendim mendon se AK — komisioni i vlerësimit, nëse ka pasur dyshime ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe bazuar ne nenin 39 te RRUOPP-së. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te Iartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë pjesërisht të qëndrueshme.

Përgiigie në Pretendimi nr.4, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se pajisjet e kërkuar nga FDT është dashur te jenë nga: Lista e mjeteve te punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për këto automjete duhet te ofroj listën e mjeteve te punës te nënshkrua dhe vulosur ne origiinal te dëshmuar me libreza te regjistrimit valide, faturë për blerjen (me dëshmi pagese), DUD doganor ne emër te kompanisë me te cilin konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë, pikat ne ankesë nga OE ankues si me lart ne këtë raport ne faqe 3, m), n), o), p), q), r), s), t), u), v), ë), dhe x)

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, bazuar ne nenin 9.1 & 9.2 pika 7 te FDT-se, po citoj: Kërkesa 7 - Lista e mjeteve te punës dhe atë se paku - 5 ekskavator, - 6 kamion kiper, - I kamion për transport - 5 kamionët për transport - I cilindër (vibrues), - I Skip me rrota me łopate para dhe krah mbrapa - I Pirnunier per ngarkim-shkarkim 1- Damper I- Korpë hidraulike se paku 10 metra lartësi ngritëse - I grejder,-1

Autobetonjere e vogël I- Autocisterrnë për ujë - 1 Vinę statik për ndërtimtari, - Skele ndërtimi së paku 2500m2" Dëshmia 7: Lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për këto automjete duhet te ofroj listën e mjeteve te punës te nënshkruar dhe vulosur ne origiinal te dëshmuar me libreza te regiistrimit valide, fature për blerjen (me dëshmi pagese), dud doganor në emër të kompanisë me të cilën konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë. Grupi i OE përveę listave te

pajisjeve te ofruar ne emër te grupit te OE, ai ka ofruar edhe disa marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve, andaj AK — komisioni i vlerësimit është përgiegjës për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas njoftimit per kontrate dhe dosjes se tenderit, duke respektuar nenin 9.1 & 9.2 kërkesa/dëshmia 7 te FDT-se si dhe ne pajtim me nenin 59 par. 4 te LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegishëm vetëm nëse tenderi në fialë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Duke u bazuar ne këto fakte te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES: Olti Trasing, Shpk,;Sinani Ing Shpk,; Beni Dona Plast Shpk — Prishtinë

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK — komisioni i vlerësimit ka shkelurnenin 7, 59, 108/A te LPP-se si dhenenin 41 te RRUOPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, AK — ZPP, nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik" si dhe neni 59 par. 3 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen giatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë me shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, ęmimi per njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar giithmonë do të konsiderohet si ęmim mbizotërues mbi ędo ęmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kérkohen qmimet per njési, elementet e qmimit té vetém tö qmimit total te ofruara nga operatori ekonomik né tenderin e tij financiar giithmoné do te konsiderohen si gmim mbizotérues mbi qmimin total. Autoriteti kontraktues menjéheré do ti dérgojé te gjithé tenderuesve pérkatés njé njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla",

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne platformen elektronike e-prokurim, eksperti shqyrtues sqaron se AK - ZPP vendimet e nxjerra ne kérkesat Pér ri-shqyrtim nuk i ka ngarkuar tek dosja e tenderit shto dokument shtese. Po ashtu, AK — ZPP nuk ka respektuar nenin 108/A par. 12 tE LPP-sé, ku thuhet: "Kundörshtimet dhe vendimet e miratuara né pérputhje me paragrafët 8 dhe 10 té kétij neni, duhet te jene té arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, ne pérputhje me kété ligi, parashtruesit te ankesés dhe te giitha paléve te interesuara, nése ka ndonjé", sepse ne vendim e nxjerr nga AK te dates 14.05.2020, nuk jane arsyetuar ne perputhje me LPP-né, po citoj: "Pas shqyrtimit te körkesés Pér rishqyrtim nga ana juaj, ne si autoritet kontraktues konstatojmé se kerkesa juaj éshté e pabazuar" Duke u bazuar ne köto fakte te lartpérmendur dhe analizés se mesipérme vlerésoje se pretendimi i palés ne ankese ne kété piké i qöndrueshöm.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK — komisioni i vlerésimit — ZPP ka shkelurnenin I, 6, te LPP-sé.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizen e fakteve/déshmive te dokumentuara ne platformén elektronike e-prokurim, rrjedhén dhe analizén procedures se prokurimit, lidhur me kété aktivitet te prokurimit, OE ankues i ka paraqitur sipérfaqésisht ne ankese, pa sqaruar ne deklaraten e ankese pretendimet respektivisht shkeljet qe lidhen me kéto nene, andaj konsideroj se pretendimet e operatorit ekonomik ankues jané pjesörisht te bazuara, sepse pérveq faktit se AK ka shpallur fitues grupin e operatoreve ekonomik i cili ka dorézuar oferten me qmimin me te larte se sa OE ankues, sepse neni I dhe 6 i LPP-se flasin respektivisht obligojné te giitha autoritetet kontraktues qe duke marre ne konsiderate qéllimin dhe lenden e prokurimit jané te obliguara te sigurojné qe fondet dhe burimet publike te perdoren ne ményrén me ekonomike, transparent dhe efikase.

Pérgiigie nö Pretendimi Nr. 3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK — komisioni i vieresimit-ZPP kashkelurnenin 72 LPP-se dhenenin40.13 RRUOPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizén e fakteve/déshmive te dokumentuara ne platformén elektronike e-prokurim, rrjedhén dhe analizén procedurés se prokurimit, lidhur me köté aktivitet te prokurimit, OE ankues i ka paraqitur sipérfaqäsisht ne ankese, pa sqaruar ne deklaraten e ankese pretendimet respektivisht shkeljet qe lidhen me kéto nene, andaj konsideroj se pretendimet e operatorit

ekonomik ankues jani pjesörisht te bazuara pasi kéto nene jané ne diskrecionin dhe pérgjegiésin e autoritetit kontraktues — ZPP si dhe komisionit te vlerösimit.

Mendimi i ekspertit profesional: Duke u bazuar né sqarimet e lartpérmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qé ankesat e ()E-ve ankues, té aprovohen si ti bazuar, dhe rekomandon te anulohet B58-Njoftimi mbi vendimin e AK (njoftimit per dhénie té kontratés) dhe lénda té kthehet né Ri-vlerösim.

Autoriteti Kontraktues, me date: 29.05.2020, me ane té parashtresés, ka njoftuar OSHP-ne, se nuk pqitohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik ("LIMITPROJECT "SH.P.K. & "Mirusha Company" SH.P.K. "AK-INVEST"- Dega né Kosové & "Aksi Project SH.P.K-Prishtinö) , me date: 30.05.2020, me ané te parashtresés, ka njoftuar OSHP-ne, se pjesérisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik ("Olti Trasing" SH.P.K.-Prishtiné) me date: 29.05.2020, me ané té shkreses zyrtare Eshté njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e eksperti shqyrtues, mirepo i njéjti nuk ka kthyer pérgiigje.

Seanca dégjimore eshté mbajtur me datén: 05.08.2020, pa pranine e paléve konform nenit 24.1 té Rregullores sé OSHP-sé, e ku jané shqyrtuar shkresat e Iéndés duke e béré kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit per procedurén e prokurimit i cili pérbéhet nga: autorizimi i inicimit te aktivitetit té prokurimit, njoftimi per kontraté, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit te vlerésimit te ofertave, raporti i vlerésimit té ofertave, njoftimi per dhenie te kontratés, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional te prokurimit, dhe te gjithé parashtresat e paléve né procedure.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit té shkresave té léndés, shqyrtimit té pretendimeve ankimore te OE ankues, konstatimeve, analizes konkrete dhe rekomandimeve té ekspertit shqyrtues deklarimit té paléve né procedure, diskutimeve dhe shoshitjes sé provave né teresi gjaté seances pér shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat jané parashtruar kundér njoftimit per dhénie te kontratés.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se duke respektuar edhe vendimin tuaj ku keni aprovuar, sqarimin e propozuar nga ana jone per konvertim nga Banka Kombétare e Maqedonisé Se Veriut dhe autoriteti kontraktues i kemi premntuar edhe vertetimin e konvertimit te Halbank Ad Skopje e dates 05.05.2020 duke konvertuar vlerén e denareve ne euro me vlerén e sakté te kontrates dhe referencés e pranimit teknik nga CAGATY pér AK INVEST DOOEL, paneli shqyrtues sqaron se AK pérmes e-mail-i ka dérguar letrén standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit me datés 04.05.2020 si ne vijim: "Per referencat te cilat i keni

ofruar ne valutën denar, kërkojmë nga ana juaj qe për këto vlera te referencave te na dëshmoni me një konvertim ne valutën euro nga ajo banke ne te cilën i keni realizuar transaksionet për ato projekte", ndërsa OE ankues brenda afatit përmes e-mail-i bashkangjet këto dokumente si ne viim: a) Lista interno e kursit nr. 20315380, date 05.05.2020 Iëshuar nga HALKBANK SHA Shkup (Vulosur dhe nënshkruar nga personi përgjegjës i bankës) dhe vlera e konvertuar: 194.367.763 MKD 3.150.502,58 EURO e përkthyer nga përkthyesi Gjygjësor z. Agron Qerreti — Prishtine, andaj bazuar ne kërkesën për sqarim nga AK, dëshminë e prezantuar nga OE ankues dhe arsyetimin nga AK ne Ietrën standarde për tenderuesin e eliminuar, paneli shqyrtues vlerëson se AK ka kërkuar sqarime konform nenit 59 dhe 72 nga OE ankues, mirëpo i njëjti nuk ka dëshmuar ashtu siç ka kërkuar AK lidhur me vlerën e saktë të konvertimit të denarëve në euro, andaj paneli shqyrtues e vlerëson pretendimin ankimor si të pa qëndrueshëm.

Përgjikie në pretendimet ankimore të OE ankues "Limit project" sh.p.k. — Prishtine ne lidhje me operatorin ekonomik te rekomanduar për dhënie te kontratës.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se çmimi i operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë-- Grupi i OE B.Bardhi Shpk,; EURO - INFRASTRUKTURA, ne formularin e ofertës kanë paraqitur çmimin total me TVSH: 3,299,321.76 €, pas krahasimit te paramases se ofertuar dhe kontrollimit, del se grupi i OE ka bere fshehje te çmimit real, ku del vlera reale e tenderit sipas çmimeve njësi te përmasës se ofertuar ne lartësinë prej 3,607,660.30 €, ku diferenca e çmimit real dhe atij te paraqitur ne formularin e ofertës është 308,338.54 €, paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes email-it ka sqaruar se në paramasen e projektit: Ndërtimi i Qendrës Multifunksionale në Ferizaj - projekt trevjeçar, ne fq. 2 dhe fq. 3 te paramases - pos 5 PUNËT E ARMATURËS është bërë kjo Ilogaritje:

Tek punët e armaturës sasia e armaturës është e mbledhur nga Poz 5.1 .I deri ne Poz. 5.1.5

Totali i armaturës në kg ku vlera totale e kolonës se Sasisë është 414289 kg e Cila kur te shumëzohet me çmimin për njësi 0.7 del te jete 290.002,538 €. Kjo shume është e barabarte me mbledhjen e shumave nga Poz. 5.1.1 deri ne Poz. 5.1.5.

Shembull:

Kolona 4 ------ 15077 kg + 9870 kg + 172708 kg + 18139 kg + 198495 kg = 414289 kg

Kolona 5 ------është dhënë çmimi për njësi për secilin profil të armaturës.

Kolona 6------10.554,075 + 6.909 + 120.895,027 + 12.697,027 + 138.946.50 290.002,538 €, ku kjo vierë është edhe Vlera totale e pozicionit 5, andaj bazuar në sqarimin e AK-së të dhënë me shkrim paneli shqyrtues vlerëson se është i paqëndrueshëm pretendimi ankimor i OE ankues dhe se nuk ka gabime aritmetikore në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, andaj pretendimi ankimor i OE ankues, është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se grup i rekomanduar për kontratë 0E B.Bardhi Shpk,; Linda,; Euro — Infrustruktuara— ka prezantuar kamionët me korp (sipas librezës) te tipit Mercedes 308 D me tabela 662—KS—084, cila nuk e plotëson kriterin e kërkuar sipas FDT pika 9.1 & 9.2 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 7, paneli shqyrtues sqaron se 0E ankues nuk ka dhëne ndonjë sqarim se pse kjo kamionët me korp (sipas librese) te tipit Mercese 308 D me tabela 662 — KS — 084, nuk plotëson kërkesën, mirëpo bazuar ne nenin 9.1 & 9.2 pika 7 te FDT-se, citat: Kërkesa 7 - Lista e mjeteve te punës dhe atë se paku - 5 ekskavator, - 6 kamion kiper, - 1 kamion për transport - 5 kamioneta për transport - I cilinder (vibrues), - I Skip me rrota me lopate para dhe krah mbrapa - I Pirnunier për ngarkim-shkarkim I- Damper I- Korpë hidraulike se paku 10 metra lartësi ngritëse - I grejder, -l Autobetonjere e vogël I- Autocis terrnë për ujë - 1 Vinę statik për ndërtimtari, - Skele ndërtimi së paku 2500m2", ndërkaq si dëshmi është kërkuar: Lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për këto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punës te nënshkruar dhe vulosur ne origiinal te dëshmuar me libreza te regiistrimit valide, fature per blerjen (me dëshmi pagese), dud doganor në emër të kompanisë me të cilën konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë. Paneli shqyrtues konform edhe sqarimeve te ekspertit profesional te prokurimit, vlereson se nga dokumentacioni vërehet se Grupi i 0E ne listen e mjeteve ka ofruar 6 kamionët për transport, andaj paneli shqyrtues konsideron se grupi i 0E e ka plotësuar këtë kërkesë te FDT-se, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme paneli shqyrtues konstaton se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se referencat e premntuara për punë te ngiashme, nuk janë për punët e ngiashme, dhe si rrjedhoje duhet te eliminohen, për shkak se referenca per ndërtimin e listuar me nr. I më vlere 1,000,000.00 € është jo valide sikurse ajo e listuar me nr. 4 me vlere 3,000,000.00 €, për shkak se këto kontrata duhet te dëshmohen me leje ndërtimore dhe një pranim teknik nga një ekip profesional se punët janë kryer sipas projektit apo lejes nëse janë kryer, nëse nuk ka leje ndërtimore, atëherë është objekt ilegal dhe shteti nuk duhet te favorizoje aktivitetet ilegale, paneli shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike edhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2 te FDT-se, po citoj: kërkesa I Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje nje vlere per punët e kryera jo me pak se 4,500,()00.00 €. Dëshmia I: Lista e kontratave (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te realizuara giate tri viteve te fundit nga data e njoftimit për kontrate te këtij tenderi ne origiinal, te nënshkruar dhe vulosur nga 0E, te dëshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te punëve te kryera ne Iëmin e punëve te ngiashme (objekte ndërtimore dhe instalime ne objekte ndërtimore), te cilat tregojnë vlerën, datën. Grupi i 0E ka dorëzuar listën e kontratave te nënshkruar dhe vulosur te dëshmuara me kontrata dhe referenca për kryerjen e punëve te ngjashme, andaj paneli shqyrtues vlerëson se grupi i OE ka arrit te plotësoj këtë kërkesë te FDT-se pasi qe OE fitues ka prezantuar referencat për punët e kryera dhe vlera e referencave. Nga AK është dëshmuar se OE i ka arguementuar edhe ne raportin e auditimit këto, andaj paneli shqyrtues e konsideron si të pabazuar pretendimin ankimor.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se tek lista e punëtorëve, punëtoret e kompanisë LINDA Sh.p.k. Bexhet Koxha, Gazmend Terzija dhe Isak Koxha, kane nënshkruar një kontratë me një person i cili është ne listën e punëtorëve, por nuk është pronar dhe as nuk ka ndonjë autorizim nga noteri apo autorizim te thjeshte për nënshkrimin e kontratave. Personi i nënshkruar si pronar i kompanisë LINDA është Afet Terzija, gië që, rrjedhimisht, eliminohet 3 punëtor dhe lista e punëtorëve te deklaruar bie nga 71 ne 68 punëtor, gië qe nuk e plotëson kushtin sipas dosjes se tenderit. Paneli shqyrtues konform edhe sqarimeve te ekspertit profesional te prokurimit, sqaron se antari i grupit "Linda" Sh.p.k. ka prezantuar një liste me 18 punëtoreve te thjeshte, ne te cilën janë edhe këta punëtore: Afet Terezija, Behxhet Koxha, Gazmend Terzija dhe Isak Koxha. Mirëpo kësaj liste i janë bashkangiitur edhe kontratat për këta punëtor, z Afet Terzija ka te nënshkruar kontrate ne pozitën: Kryepunëtore (e nënshkruar nga dy palët dhe te vulosur), kurse kontrata për punëtoret ne fjale janë te nënshkruar ngaz Afet Terzija — ku ne nenin I te kontratës po citoj: "Te cilën e përfaqëson: Afet Terzija" (si punedhenes — Pronar te nënshkruar nga palët dhe te vulosur me vule te fimres "Linda" Sh.p.k.). Autoriteti kontraktues përmes email-it ka ka ofruar dëshmi që sqarojnë se Afet Terezija, ka qenë drejtor i kompanisë në kohën kur është nënshkruar kontrata që ka cekur OE ankues, mirëpo sipas dëshmisë së ofruar nga AK, certifikata e regjistrimit të biznesit të ARBK-së shihet se tani pronar i OE "Linda" shpk është Hysri Berisha, andaj duke marrë në konsideratë dëshmitë e ofruara nga autoriteti kontraktues paneli shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se tek lista e te punësuarve me certifikate te sigurisë, eliminohen dy punëtor te cilët e kane nënshkruar kontratën me z Afet Terzija, pra punëtorët Gannend Terzija dhe Isak Koxha, eliminohen nga kjo liste për shkak se janë me kontratë te pavlefshme dhe rrjedhimisht, nunëri i të punësuarve me certifikate te Sigurisë te jete: 8 nga 10 te prezantuar. Paneli shqyrtues sqaron se lidhur me këtë pretendim ka dhënë sqarimin më lartë andaj edhe ky pretendim ankimor nuk është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues shqyrtoj dhe analizoj pretendimet ankimore të OE ankues "Limit" shpk ndaj OE të dytë ankues konzorciumit "Olti Trasing & Sinani SHPK & Beni Dona"

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Kalkulimi i ęmimit: Grupi i OE ne formularin e ofertës kane paraqitur ęmimin total me TVSH: 3, 188,000.00 €, pas krahasimit te paramases se ofertës se ofruar dhe kontrollimit, del se grupi i OE ka béré fshehje te çmimit real, ku del vlera reale e tenderit sipas çmimeve njési te paramases se ofertuar ne lartesiné prej 3,823,744.17 g, ku diferenca e çmimit real dhe atij te paraqitur ne formularin e ofertés eshté 635,744.17 e, paneli shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne raportin e vlerésimit te dates 06.05.2020, pasi aty komisioni i vlerêsimit te DEKLARATÉ, nuk ka dhené asnjê arsye pér eliminimin e OE pjesêmarrés ne kêtê aktivitet te prokurimit, as tek informatat lidhur me gabimet ne Ilogaritjet; dhe as tek informatat shtese tek sqarimet dhe rrjedhimisht komisioni i vlerêsimit nuk ka respektuar

vendimin per formimin e komisionit me nr. 01-33/2020 te dates 28.04.2020 si dhe nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 té LPP-sê: "Autoriteti kontraktues nuk do té ekzekutojé asnje aspekt té aktivitetit té prokurimit né njé menyre që redukton apo eliminon konkurrencên né mes té operatoréve ekonomik ose diskriminon né dém ose ne té miré te nje ose me shume operatoreve ekonomik" si dhe neni 59 par. 3 té LPP-sé: "Autoriteti kontraktues do té pérmirêsojê gabimet né njê tenderé té cilat jane teresisht aritmetike, nêse gabimet e tilla zbulohen giatê ekzaminimit té tenderéve sidoqoftê ky pérmirêsim nuk mund té jeté mé shumé se dy pérqind (2%) i vlerês totale té ofertes. Né njê rast té tillé, çmimi pér njesi i ofertuar nga operatori ekonomik né tenderin e tij financiar gjithmoné do té konsiderohet si çmim mbizotérues mbi çdo çmim tjetér kontradiktor. Kur nuk kérkohen çmimet per njési, elementet e çmimit té vetém té çmimit total té ofruara nga operatori ekonomik ne tenderin e tij financiar gjithmonê do té konsiderohen si çmim mbizotêrues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjêheré do ti dérgojé té giithé tenderuesve pérkatês njé njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla". Konkretisht komisioni i vlerésimit, nuk ka vleresuar dhe krahasuar pershkrimin e çmimeve tek paramasa dhe parallogari te operatoreve ekonomik pjesémarrêse ne kété aktivitet te prokurimit, gjithashtu ¿shtê pérgiegjêsi e komisionit te vlerésimit te analizoj, krahasoj dhe ekzaminoj, te zbulohen gabimet ne Ilogaritje dhe te gjeje pêrqindjen e gabimit ne Ilogaritje te çmimeve te ofertave finacare nga operatoret ekonomik dhe te njoftohen pérmes letres standarde e njoftimit pér Ilogaritje te gabuar. Duke u bazuar ne kéto fakte te lartpérmendur dhe analizés se mesipêrme vlerêsojê se pretendimi i palés né ankese ne kétê pikê éshté i qéndrueshêm pasi qe per panelin shqyrtues eshte irelevante se a ka gabime aritmetikore apo jo OE ne fjalê pasi qe êshtê i pa pérgjegishém.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se prezantimi i listes se puneve nuk éshté bindés, me shume ka pune infrastrukturore sesa pune ndêrtimore te objekteve te ngiashme (ndértim i larte). Paneli shqyftues sqaron se grupi i OE ka sjelle listen e kontratave te realizuar te nénshkruar dhe te vulosur ne vlere 5,041,614,91 €, dhe bazuar Kérkesat mbi mundêsité teknike edhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2 te FDT-se, po citoj: Kérkesa I Operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroje njê vlere pér punét e kryera jo me pak se 4,50(),()()0.0() €. Déshmia I Lista e kontratave (e nênshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet te ofroj listen e kontratave te realizuara giate tri viteve te fundit nga data e njoftimit pér kontrate te kêtij tenderi ne origjinal, te nênshkruar dhe vulosur nga ()E, te dëshmuar me referenca apo raporte te pranimeve teknike te punëve te kryera ne lëmin e punëve te ngjashme (objekte ndërtimore dhe instalime ne objekte ndërtimore), te cilat tregojnë vlerën, datën. Andaj paneli shqyrtues vlereson se grupi i operatoreve ekonomik plotëson këtë kërkesë te FDT-se dhe pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se diploma e menaxherit te kontratës z. Azem Gashit, nuk është skanuar origjinali i kopjes se noterizuar, por kopja e kopjes se noterizuar, kështu qe konsiderohet e pavlefshme njëjte edhe z. Fatjon Bajselmani, gjeodeti, Fadil inxhiner hidros, njëjte edhe i elektrikes. Ne

dosjen e tenderit është kërkuar kopja nga origjinali, paneli shqyrtues sqaron se grupi i operatori ekonomik ka dorëzuar diplomat e stafit profesional (kopje te noterizuara), andaj dorëzimi i dokumenteve përmes platformes elektronike, dokumentet nuk janë origjinale por janë te skanuara, kjo është sqaruar edhe ne vendimin PSH. Nr. 191, 210/2020 te datës 23.04.2020. këto pikajanë pjesërisht të qëndrueshme.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se pajisjet e kërkuar nga FDT është dashur te jenë nga: Lista e mjeteve te punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për këto automjete duhet te ofroj listën e mjeteve te punës te nënshkruar dhe vulosur ne origjinal te dëshmuar me libreza te regiistrimit valide, faturë për blerjen (me dëshmi pagese), DUD doganor ne emër te kompanisë me te cilin konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë, pikat ne ankesë nga OE ankues si me lań ne këtë raport ne faqe 3, m), n), o), p), q), r), s), t), u), v), ë), dhe x). Paneli shqyrtues sqaron se bazuar ne nenin 9.1 & 9.2 pika 7 te FDT-se, po citoj: Kërkesa 7 - Lista e mjeteve te punës dhe atë se paku - 5 ekskavator, - 6 kamion kiper, - I kamion për transport - 5 kamionët për ra1220201nsport - I cilindër (vibrues), - I Skip me rrota me lopate para dhe krah mbrapa - I Pirnunier për ngarkim-shkarkim, 1- Damper, 1- Korpë hidraulike se paku I O metra lartësi ngritëse, I grejder, -I Autobetonjere e vogël 1- Autocisterrnë përujë - 1 Vinq statik për ndërtimtari, - Skele ndërtimi së paku 2500m2", ndërkaq si Dëshmi është kërkuar: Lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik përkëto automjete duhet te ofroj listën e mjeteve te punës te nënshkruar dhe vulosur ne origiinal te dëshmuar me libreza te regiistrimit valide, fature për blerjen (me dëshmi pagese), dud doganor në emër të kompanisë me të cilën konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë.
Paneli shqyrtues duke u bazuar në kërkesën e AK-së sqaron se pretendimi ankimor i OE ankues për këtë pikë është i bazuar për faktin se operatori ekonomik "Olti Trasing& Beni Dona" ka ofruar listën e pajisjeve edhe disa marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve, mirëpo kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë OE duhet të dorëzoj listën e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur) ne origiinal te dëshmuar me libreza te regiistrimit valide, fature për blerjen (me dëshmi pagese), dud doganor në emër të kompanisë me të cilën konkurron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilët konkurrojnë e jo të dorëzoj listë të mjeteve me qira, andaj paneli shqyrtues konsideron se OE "Olti Trasing" né kétê kérkesê té dosjes sé té tenderit éshté i papergjegjshém.

Pérgjigje né pretendimet ankimore ti OE ankues: Olti Trasing, Shpk, Sinani Ing Shpk,; Beni Dona Plast Shpk — Prishtinê

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK — komisioni i vlerêsimit ka shkelur nenin 7, 59, 108/A te LPP-se si dhe nenin 41 te RRUOPP-sê, paneli shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne platformen elektronike e-prokurim, AK - ZPP vendimet e nxjerra ne kérkesat pér ri-shqyrtim nuk i ka ngarkuar tek dosja e tenderit shto dokument shtese. Po ashtu, AK — ZPP nuk ka respektuar nenin

108/A par. 12 té LPP-sé, ku thuhet: "Kundêrshtimet dhe vendimet e miratuara né pérputhje me paragraÑt 8 dhe IO té kétij neni, duhet té jenê té arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, né pérputhje me kétê Iigj, parashtruesit té dhe te gjitha paléve té interesuara, nése ka ndonjê", sepse ne vendim e nxjerr nga AK te datés 14.05.2020, nuk jane arsyetuar ne pérputhje me LPP-nê ku thuhet: "Pas shqyrtimit te kérkesés per rishqyrtim nga ana juaj, ne si autoritet kontraktues konstatojmê se kérkesa juaj éshté e pabazuar" andaj pretendimi ankimor éshté pjesêrisht i qêndrueshem sa i pérket pretendimit pér shkelje té nenit 108?A té LPP-sê.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK — komisioni i vlerêsimit — ZPP ka shkelur nenin I, 6, te LPP-sê, paneli shqyrtues sqaron se OE ankues i ka paraqitur sipérfaqêsisht ne ankese pretendimiet ankimore lidhur me kété pikê, pa i arsyetuar dhe sqaruar né deklaratén e ankeses pretendimet respektivisht shkeljet qe lidhen me kêto nene. Paneli shqyrtues konstaton se kriter i tenderit ka qené tenderi i pérgiegieshém me cmim me té ulêt, andaj AK ka shpallur fitues grupin e operatoreve ekonomik i cili ka dorézuar oferten me çmimin me te larte se sa OE ankues, mirêpo oferta e ankuesit né kêtê rast éshtê e papêrgiegieshme per faktin se OE ne fjalé nuk i ka dorézuar paisjet pér makineritê konfrom kérkesês sé tenderit 9. 1 & 9.2 andaj paneli shqyrtues e konsideron pretendimin ankimor si té pa qéndrueshem.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK — komisioni i vleresimit — ZPP ka shkelur nenin 72 LPP-sé dhe nenin 40.13 te RRU()PP-se, paneli shqyrtues sqaron se OE ankues i ka paraqitur sipérfaqêsisht ne ankese, pa sqaruar ne deklaratên e ankese pretendimet respektivisht shkeljet qe lidhen me kéto nene, andaj konsideroj se pretendimet e operatorit ekonomik ankues jane te pa bazuara pasi kêto nene jane ne diskrecionin dhe pérgjegiêsin e autoritetit kontraktues — ZPP si dhe komisionit te vlerêsimit.
Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgiegishëm me ęmim më të ulët, duke rekomanduar për dhënie te kontratës Operatorin Ekonomik që ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me ęmim me te lire nga te giithë ofertuesit e përgiegishëm. Dhe se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave i është përmbajtur në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin I të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligii është të sigurojë mënyrën më efikase, rnë transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të giitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu się parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kunder këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesepadi mund t'i drejtohet Gjykates themelore-Departamentit per çështje Administrative ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit te këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Ferizaj

1x1 OE- "LIMITPROJECT "SH.P.K.

1x1 OE "01ti Trasing" SH.P.K.-Prishtinë 1x1

Arkivës se OSHP-së;

1x1 Për publikim ne ueb- faqe te OSHP-së.